



REPUBLIKA E MAQEDONISË SE VERIUT  
MINISTRIA E EKONOMISË DHE PUNËS

Në bazë të Programit për mbështetjen e konkurrencës së industrisë përpunuese dhe përgjegjësisë shoqërore për vitin 2024, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 15/2024), pjesa II, fusha A, IMplemeni Politikës Industriale, Masa 5, Nxitja e pilot projekteve novatore dhe bashkëpunuese në lidhje me specializimin, transformimin e gjelbër dhe digjital në heliks të katërfishtë, Ministria e Ekonomisë dhe Punës (MEP) shpallë:

THIRRJE PUBLIKE

për

zhvillim dhe implementim i projekteve novatore dhe bashkëpunuese në lidhje me specializimin e mençur, transformimin e gjelbër dhe digjital në heliksin e katërfishtë.

**Lëndë e Thirrjes Publike:** Bashkëfinancimi i projekteve novatore, kërkimore dhe zhvillimore në lidhje me specializimin e mençur, transformimin e gjelbër dhe digjital në fushën e domeneve të përcaktuara në përputhje me Strategjinë e specializimit të mençur<sup>1</sup>, të realizuar në partneritet për bashkëpunim midis akademisë dhe biznesit, si dhe faktorëve të tjerë nga heliksi i katërfishtë<sup>2</sup>.

**Baza për sigurimin e mbështetjes:** Programi për mbështetjen e industrisë përpunuese dhe përgjegjësisë shoqërore për vitin 2024, Masa 5.

*Për krijimin e ekonomisë konkurruese, e cila bazohet në inovacion dhe njohuri, është e nevojshme të forcohen lidhjet dhe partneritetet midis biznesit, akademisë, shoqatave dhe palëve të tjera të interesuara, në mënyrë që t'i shfrytëzojnë kapacitetet dhe potencialet ekzistuese për zhvillim. Duke bashkëfinancuar një pjesë të shpenzimeve për iniciativa të reja, nxitet vendosja dhe formalizimi i bashkëpunimit afatgjatë midis palëve të interesuara nga heliksi i katërfishtë (bizneset, akademia, shoqatat afariste dhe institucionet shtetërore), duke u bazuar në hulumtim, zhvillim dhe inovacione. Bashkëpunimi dhe investimet e përbashkëta në projekte konkrete do të kenë ndikim pozitiv në konkurrencën e subjektit të afarist, do të transferohen përvojat e subjekteve të tjera të afariste dhe do të hapen mundësi të reja tregu. Koncepti i dialogut dhe bashkëpunimit është zhvilluar në procesin e zhvillimit të Strategjisë së specializimit të mençur, ndërsa qëllimi është që përmes vazhdimit të dialogut të përcaktohen dhe realizohen projekte fillestare për bashkëpunim në heliksin e katërfishtë dhe investime të përbashkëta në hulumtim, zhvillim, inovacione që çojnë në zhvillim, specializim, transformim të gjelbër dhe digjital.*

Thirrja publike zbatohet në përputhje me Udhëzuesin për realizimin e Masës 5: Nxitje të projekteve novatore dhe bashkëpunuese në lidhje me specializimin e mençur, transformimin e gjelbër dhe digjital në heliks të katërfishtë ku përshkruhen në detaje mënyra dhe kushtet për ndarjen e mjeteve financiare për Masën 5.

<sup>1</sup> <https://mon.gov.mk/content/?id=8443>

<sup>2</sup> Четворниот хеликс го сочинуваат претставници од: бизнисот, академијата, деловни здруженија и државни институции

## **Qëllimi:**

Qëllimi i thirrjes publike është zhvillimi dhe implementimi i projekteve në kuadër të cilave do të vendoset dhe formalizohet bashkëpunimi afatgjatë midis faktorëve ga heliksi i katërfishtë dhe palëve të tjera të interesuara. Projektet duhet të nxisin specializimin, transformimin e gjelbër dhe digjital në sektorin privat duke përdorur shërbimet nga akademja për të transferuar njohuritë, inovacionet dhe teknologjitë, për të krijuar produkte, shërbime dhe procese të reja ose për të përmirësuar të produkteve, shërbimeve dhe proceseve ekzistuese me vlerë të lartë të shtuar që do të jenë konkurruese në tregjet e brendshme dhe ndërkombëtare.

Pritet që rezultatet nga implementimi i projekteve pritët të kontribuojnë në rritjen e konkurrencës së subjekteve afariste nga industria përpunuese dhe domenet e Strategjisë së specializimit të mençur.

## **Llojet e projekteve që do të mbështeten:**

Me Thirrjen publike do të mbështeten projektet që përfshijnë bashkëpunimin, respektivisht partneritetet midis përfaqësuesve të heliksit të katërfishtë, e kryesisht midis biznesit dhe akademisë. Bashkëpunimi duhet të përqendrohet në aktivitetet hulumtuese dhe zhvillimore, si dhe në adoptimin ose përshtatjen e teknologjive novatore, të avancuara, proceseve teknologjike dhe know-how. Projektet duhet të kontribuojnë në specializimin, transformimin e gjelbër dhe digjital të ndërmarrjeve, si dhe në tejkalimin e hendekut midis njohurive ekzistuese në nivel global dhe atyre që i kanë industritë lokale.

Te **subjektet afariste**, bashkëpunimi duhet të rezultojë me:

- Përmirësimin e proceseve ekzistuese ose vendosjen e proceseve të reja afariste me qëllim të rritjes së produktivitetit dhe efikasitetit në funksionimin;
- Krijimin e kushteve për inovacione respektivisht zhvillimin e produkteve dhe/ose shërbimeve të reja;
- Inicimin e bashkëpunimit me sektorin privat, shoqatat afariste dhe/ose institucionet shkencore dhe arsimore për hulumtim dhe zhvillim të përbashkët;
- Inovacione në drejtim të specializimit, transformimit të gjelbër dhe digjital;
- Zhvillim i kapitalit dhe shkathtësive njerëzore veçanërisht në fushën e specializimit të transformimit të gjelbër dhe digjital;
- Gatishmëri më e mirë për ndërkombëtarizimin dhe miratimin e kërkesave të tregut global.

Te **institucionet shkencore-hulumtuese**, bashkëpunimi duhet të rezultojë me:

- Forcimin e kapaciteteve për bashkëpunim për hulumtim dhe zhvillim dhe gatishmëri të rritur për t'iu përgjigjur kërkesave dhe nevojave specifike të sektorit privat, transferimit të njohurive dhe shkathtësive;
- Zhvillimin e shërbimeve që do t'i ofrohen sektorit privat dhe që janë në drejtim të specializimit, transformimit të gjelbër dhe digjital;
- Përfshirjen e hulumtuesve të rinj në projekte.

Te **shoqatat afariste**<sup>3</sup>, bashkëpunimi duhet të rezultojë me:

---

<sup>3</sup> Се вклучуваат сите субјекти регистрирани согласно Законот за здруженија и фондации и Законот за стопански комори

- Përvetësim të njohurive të reja, praktikave dhe shërbimeve të mira, të cilat do t'i transferohen anëtarësisë.

Bashkëpunimi i vendosur duhet të ketë ndikim sektorial dhe kontribut pozitiv afatgjatë në rritjen e konkurrentësisë së ndërmarrjeve nga industria përpunuese.

### **Kohëzgjatja e projektit**

Zbatimi i projektit mund të jetë më së shumti deri në 9 muaj.

Raporti përfundimtar duhet të dorëzohet jo më vonë se 1 muaj nga përfundimi i projektit.

### **Buxheti i thirrjes publike**

**Vlera e përgjithshme e masës:** 15.000.000 denarë

**Lloji dhe shuma e mbështetjes:** Për realizimin e projektit, MEP-ja siguron mbështetje financiare prej maksimumi 50% të buxhetit të përgjithshëm të projektit, por jo më shumë se 3.000.000,00 denarë individualisht për projekt. Partneri udhëheqës, respektivisht partnerët duhet të marrin pjesë me fonde në lartësi prej të paktën 50% të buxhetit të përgjithshëm të projektit.

Marrëveshja e financimit do të lidhet midis MEP dhe Partnerit udhëheqës, ku pagesa e mjeteve nga MEP-ja do të bëhet në formë të paradhënies, pas lidhjes së Marrëveshjes së Partnerit udhëheqës me MEP dhe dorëzimit të dëshmisë së pagesës së pjesëmarrjes së vet për tremujorin e parë nga zbatimi i projektit.

Mënyra e ndarjes së shpenzimeve midis partnerëve duhet të rregullohet me Marrëveshje për partneritet..

Aplikimet e aprovuara do t'u paguhen aplikantëve në varësi të mjeteve që janë në dispozicion nga Buxheti për vitin 2024, të parashikuara për këtë dedikim, deri në shterjen e mjeteve.

MEP-ja rezervon të drejtën të mos japë mjete nëse nuk ka propozim-projekte të mjaftueshme cilësore ose nuk janë plotësuar kushtet për dhënien e mjeteve.

### **Kush mund të aplikojë?**

Aplikimi në këtë thirrje duhet të jetë në formën e partneritetit me ç'rast të drejtën e aplikimit e ka vetëm një nga partnerët, respektivisht partneri udhëheqës.

Partner udhëheqës mund të jetë:

:

- Subjekti afarist, gjegjësisht personi juridik, i themeluar në përputhje me Ligjin për shoqëritë tregtare dhe i regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut,

Gjatë aplikimit, përveç përfaqësuesve nga biznesi, në partneritetin duhet të përfshihen edhe përfaqësues nga akademia, ndërsa do të konsiderohet si përparësi dhe përfshirja e institucioneve, organizatave joqeveritare/

odave ekonomike/ shoqatave të qytetarëve, ekspertëve individualë dhe palëve të tjera të interesuara që lidhen me fushën dhe aktivitetet e parashikuara në projektin.

Partneritetet duhet të formalizohen me marrëveshje, e cila do të definojë qartë se kush është bartësi i projektit, respektivisht partneri udhëheqës, duke përfshirë rolin, detyrat dhe përgjegjësitë e secilit prej anëtarëve të partneritetit, si dhe të drejtën për të pasur në dispozicion rezultatet e projektit. Marrëveshja midis partnerëve është pjesë përbërëse e aplikimit.

Ndarja e mjeteve nga MEP për këtë thirrje publike paraqet ndihmë shtetërore në kuptim të nenit 5 paragrafi (1) të Ligjit për kontrollin e ndihmës shtetërore, që si ndihmë horizontale në kuptim të nenit 4 paragrafi (1) pika 1 e jep MEP-ja, me ç'rast ndarja e së njëjtës lejohet si ndihmë për projekte hulumtuese dhe zhvillimore, në përputhje me nenin 8 paragrafi (2) të Ligjit dhe nenin 6 të Urdhëresës për kushtet dhe procedurën e dhënies së ndihmës horizontale.

Një partneritet mund të parashtrojë vetëm një aplikim.

#### **Ekipi i projektit:**

Ekipi i projektit duhet të përfaqësojë partnerët në projektin dhe të ketë së paku pesë anëtarë nga të cilët:

- Një person përgjegjës për realizim dhe koordinim (përfaqësuesi i Partnerit udhëheqës);
- Të paktën një anëtar i ekipit duhet të jetë doktor i shkencave në këtë fushë;
- Të paktën një anëtar i ekipit duhet të ketë përvojë në projekte hulumtuese dhe zhvillimore;
- Ekipi duhet të përfshijë edhe të paktën dy studiues të rinj (studentë në vitin e fundit të studimeve universitare, magistraturë, doktoraturë).

### **Aktivitetet e projektit**

Aktivitetet që mund të përfshihen në projektin:

- hulumtim dhe zhvillim;
- zhvillimin e linjave pilot/produkteve/dhe ose shërbim-it/eve;
- testimin dhe validimin e produkteve/shërbimeve/proceseve të reja dhe/ose të avancuara;
- mbrojtjen e pronësisë intelektuale;
- dizajni;
- zhvillimin e shkathtësive dhe trajnimeve;
- diseminimin e përvojës nga projekti i palëve të treta;
- nxitjen e dialogut të vazhdueshëm të akademisë dhe biznesit;
- aktivitetet e qëndrueshmërisë së projektit dhe
- aktivitete të tjera që lidhen me qëllimet e projektit

### **Shpenzime të pranueshme për financim**

Shpenzimet e pranueshme në buxhetin e projektit duhet të korrespondojnë me aktivitetet e parashikuara në aplikimin e projektit. Vetëm shpenzimet e shkaktuara për aktivitetet e zbatuara gjatë kohëzgjatjes së projektit, e që janë në përputhje me Buxhetin e aprovuar të Projektit do të konsiderohen shpenzime të pranueshme.

Shpenzimet e drejtpërdrejta në lidhje me realizimin e projektit::

- Pagat bruto për personat e punësuar te Partnerit udhëheqës, respektivisht partnerët e projektit që janë të angazhuar në projektin (shumat e pagave bruto e të punësuarve-të angazhuar në projektin duhet të korrespondojnë me praktikat e vendosura të partnerëve para fillimit të projektit);
- Furnizimi dhe/ose dhënia me qira e pajisjeve dhe materialeve harxhuese për hulumtim dhe zhvillim;
- Shërbime nga ekspertë/këshilltarë/konsulentë (për hulumtim, zhvillim, testim, zhvillim të biznesit, trajnim, etj.)/ shpenzime që lidhen me angazhimin e personave të jashtëm (persona fizikë dhe/ose juridikë) për shërbimet e hulumtimit dhe zhvillimit, testimin, zhvillimin e biznesit, trajnimin, etj.;
- Shpenzime të tjera operative që lidhen drejtpërdrejt me realizimin e projektit;
- Furnizimi i literaturës, zhvillimi dhe furnizimi i zgjidhjeve TIK.
- Përpilimi i Studimit të projektit të realizuar (Case Study) për promovimin e rezultateve.

Lista e shpenzimeve të pranueshme nuk është shteruese..

## Shpenzime e papranueshme për financim

- Shpenzimet për pagat e të punësuarve te një partner i projektit, të cilët tashmë janë mbuluar nga mjetet e buxhetit;
- Shpenzimet për furnizimin e mallrave, shërbimeve dhe punëve nga ndërmarrjet vendore publike, përveç shpenzimeve të përgjithshme;
- Shtesat e pagës në formën e regresit për pushimin vjetor, paga e trembëdhjetë, performanca në punë dhe të ngjashme;
- Shpenzimet e interesit ose të borxhit të një pale tjetër;
- Shpenzimet dhe rezervimet për humbjet ose borxhet e kaluara dhe të mundshme në të ardhmen;
- Mbulimi i humbjeve për shkak të këmbimit valutor, taksave dhe gjobave;
- Shpenzimet për ushqim dhe hotelieri;
- Shpenzimet e rekrutimit të personelit (shpenzimet e publikimit të shpalljeve, provizione nga agjencitë e punësimit, shpenzimet që lidhen me përzgjedhjen e kandidatëve, etj.) dhe shpenzimet për risistemim;
- Blerja e tokës ose ndërtesave, duke përfshirë rinovimin.
- Pagesat në para të gatshme për nevojat e projektit;
- Aktivitetet e eksportit (shpenzimet që lidhen drejtpërdrejt me eksportin e produkteve, me themelimin dhe funksionimin e rrjetit shpërndarës, etj.)
- Taksat vjetore për mirëmbajtjen e patentës (duke përjashtuar rastet e justifikuara mirë të mbivlerësuara si shpenzim i lejueshëm gjatë vlerësimit të propozim-projekteve).
- Shpenzimet për shërbimet e konsulencës të ofruara nga pronar-i (ët) e partnerëve të projektit, si dhe personat e autorizuar të partnerëve të projektit (drejtuesi/drejtori);
- Shpenzimet për shërbimet e konsulencës të ofruara nga personat e punësuar nga Partneri udhëheqës;
- Qiradhënia e hapësirave afariste nga një qiradhënës i cili merr pjesë në aktivitetet e projektit ose është person i lidhur me një përdorues;
- Furnizimi i automjeteve të mallrave dhe udhëtarëve nga kompanitë që ushtrojnë transportin rrugor të mallrave me qira ose kompensim;
- Shpenzimet për realizimin e aktiviteteve të financuara më parë nga burime të tjera;
- Tatimi i Vlerës së Shtuar (TVSH), në rastet kur subjekti i përzgjedhur ka të drejtë të kthejë TVSH-në.

MEP rezervon të drejtën të negociojë me projektet e përzgjedhura në drejtim të definimit të aktiviteteve dhe buxhetit të projektit në bazë të rekomandimeve që janë marrë nga Komisioni për vlerësim dhe përzgjedhje (në tekstin e mëtejme: Komisioni), ndërsa para nënshkrimit të Marrëveshjes së bashkëfinancimit të projektit.

## Procedura e vlerësimit dhe përzgjedhjes

Procedura, nga pranimi i aplikimeve deri në përzgjedhjen dhe marrjen e vendimit përfundimtar për përzgjedhjen dhe shpërndarjen e mjeteve financiare për projektet e përzgjedhura, përbëhet nga disa hapa:

- Verifikimi administrativ i dokumenteve të dorëzuara
- Përzgjedhja paraprake
- Përzgjedhja dhe
- Marrja e vendimit për bashkëfinancim

## Kriteret për evaluimin e projekteve

Kriteret dhe nën-kriteret kryesore për evalimin e projekteve janë përshkruar në Tabelën e vlerësimit.

KRITERET PËR PËRZGJEDHJEN	PIKËT MAKSIMALE
1. A nxitet me aktivitetet e propozuara në projektin bashkëpunimi për hulumtim/inovacione/specializim/transformimi i gjelbër/digjital?	10
2. Cili është ndikimi – a siguron projekti zhvillimin e një produktit/procesit ose shërbimit të ri ose të përmirësuar?	10
3. A është koncepti i projektit i përpunuar mirë me plan të përpunuar të aktiviteteve?	10
4. A përfshihen në projekt tregues objektivë dhe të matshëm?	5
5. A ka analizë të rrezikut, me masa për ta tejkaluar?	5
6. A është përpunuar në detaje plani financiar për realizim? A janë shpenzimet të planifikuara në mënyrë adekuate dhe të paraqitura realisht?	10
7. Kapaciteti i partneritetit dhe ekipit të projektit (Numri dhe struktura e partnerëve dhe struktura e ekipit të projektit)	20
8. Kualifikimi i burimeve të propozuara njerëzore/a janë të përshtatshme për projektin - Biografitë e punës e përfaqësuesve të përfshirë të pjesëmarrësve, përvoja në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, punime të publikuara profesionale/shkencore ?	15
9. Përfshirja e hulumtuesve të rinj, numri dhe specialiteti	5
10. Qëndrueshmëria e projektit, a parashikohet partneriteti të vazhdojë të funksionojë pas përfundimit të financimit?	10
Gjithsej	100

## Komisioni i vlerësimit

Kërkesat e parashtuara i shqyrton Komisioni për vlerësim, i formuar nga ministri i Ekonomisë dhe Punës.

Komisioni do të veprojë në bazë të Rregullores së punës, e cila do të miratohet në mbledhjen e parë të Komisionit.

### **Dokumentet e nevojshme për aplikim:**

Gjatë aplikimit, partnerët e projektit detyrimisht duhet të dorëzojnë dokumentet si vijon:

- Formulari i plotësuar 1 pipoo 2024 Masa 5 "Kërkesë për aplikim";
- Formulari – Propozim-projekt;
- Formulari – Buxheti i projektit;
- Formulari i plotësuar DEKLARATË -2024 "Deklaratë e ndihmës së ndarë shtetërore", e vërtetuar në noter;
- Formulari i plotësuar "DEKLARATË-2024", e vërtetuar në noter;
- Fletëpagesat për taksat administrative në vlerë prej 50,00 denarë dhe 250,00 denarë;
- Gjendja rrjedhëse e subjekteve (të gjithë partnerët e projektit) të lëshuara nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut, jo më të vjetra se 3 (tre) muaj,
- Deklaratat e pjesëmarrësve për përfshirje në projekt, me Marrëveshje të nënshkruar për partneritet (e cila pas aprovimit të projektit duhet të vërtetohet në noter);
- Deklaratë nga bartësi i projektit me pëlqimin se pas aprovimit të projektit nga Ministria e Ekonomisë dhe Punës, do të hapet një llogari e dedikuar ku do të transferohen mjetet për realizimin e projektit, përmes së cilës do të ushtrohen të gjitha transaksionet financiare.
- Biografitë e punës së të gjithë anëtarëve të ekipit (jo më shumë se 5)

Formulari 1 pipoo 2024 Masa 5 "Kërkesë për aplikim"; Formulari - Propozim-projekt; Formulari - Buxheti i projektit; Formulari "Deklaratë 2024"; Formulari "Deklaratë 2024 për ndihmën e ndarë shtetërore"; Udhëzues për realizimin e Masës 5, janë të arritshme në UEB faqen e MEP-së: [www.economy.gov.mk](http://www.economy.gov.mk). Të njëjtat mund të merren edhe nga arkivi i MEP-së.

Kërkesa për aplikim, propozim-projekti dhe buxheti i projektit duhet të nënshkruhen dhe printohen nga Partneri udhëheqës dhe të dorëzohen së bashku me të gjitha dokumentet e lartpërmendura.

Thirrja publike publikohet në faqen e internetit të MEP-së [www.economy.gov.mk](http://www.economy.gov.mk).

## Mënyra dhe dorëzimit të kërkesave

Kërkesat së bashku me dokumentacionin e nevojshëm duhet të dorëzohen në zarf të mbyllur në Arkivin e MEP-së, rr.. „Jurij Gagarin“ nr. 15, Shkup ose dërgohen përmes postës të rekomanduar.

Nëse dokumentet dorëzohen me postë, data e dorëzimit të tyre do të konsiderohet si data kur ato kanë mbërritur dhe janë regjistruar në Arkivat e MEP-së.

Në pjesën e përparme të zarfit duhet të qëndrojë:

Drejtuar Ministrisë së Ekonomisë dhe Punës

Për THIRRJEN PUBLIKE për Zhvillimin dhe implementimin e projekteve novatore dhe bashkëpunuese në lidhje me specializimin e mençur, transformimin e gjelbër dhe digjital, me shenjën "MOS E HAP".

Në pjesën e pasme të zarfit duhet të jetë emri dhe selia e bartësit të projektit, respektivisht Partnerit udhëheqës.

### **Afati për aplikim**

Afati i fundit për dorëzimin e kërkesave është 01.11. të vitit 2024.

Për financim do të merren parasysh vetëm ato propozime të projekteve që dorëzohen në mënyrën e mësipërme dhe brenda afatit të caktuar.